

INSPEKTORATI SHITËRËTOR TEKNIK DHE INDUSTRIAL						
Regjistri i Kërkesave/Ankesave dhe Përgjigjeve ISHTI TETOR 2025						
Nr. Rendor	Data e kërkesës	Objekti I kërkesës	Data e përgjigjes	Përgjigje	Mënyra e Përfundimit të kërkesës	Tarifa
1	29.09.2025	Kërkesë - ankesë nga disa banorë në një kompleks pallatesh , Ka mbi 15 ditë që garazhet e pallateve kanë presencë të ujave të zeza që rrjedhin nga faga e pallatit.Kjo ankesë është drejtuar në disa institucione me shprehje për ta zgjidhur thellundimisht këtë situatë që është e pranisshme herë pas here.Sot ujtat e zeza kanë depertuar tok depozitat e ujit të pijshëm,situata është shumë e rrezikshme për shëndetin e dhjetra familje , dhe kërkohet ndërhyrje urgjente,sepse është rrezik për helmime dhe shpërthime epidemike. Kërkojnë Ndërhytjen menjehere për pastrimin dhe dezinfektimin e garazheve. Te identifikoni dhe të riparoni shkakun e daljes së ujaveve të zeza(blokim i kanalizimit,lidhje e gabuar ose defekt teknik).Te merren masa për te garantuar që ky problem te mos përsëritet me. Te kryhen analiza laboratorike mbi cilësinë e ujit të pijshëm.	03.10.2025	Në mbishprehje të nenit 10 të ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit” i ndryshuar, Koordinatori Për të Drejtën e informimit dërgon kërkesën për informim te një autoritet tjetër publik, brenda afatave të parashikuara në këtë ligj, kur rezultoni se autoriteti publik ku është depozuar kërkesa nuk e zotëron informacionin e kërkuar, nuk është autoritet kompetent. Pë sa më sipër lutemi trajtimin e Kërkesë -ankesës dërguar e-mail në info@ishti.gov.al- faga zyrtare e institucionit	E deleguar	0
2	01.10.2025	Kërkohet informacion për një rast te një subjekti që nuk plotëson asnjë kusht dhe kriter për tregtimin e lendeve djegëse me pakicë .Subjekti tregon gaz të lengshëm pa një certifikatë të mirëfilltë dhe komplet kontraband .Rrezik për komunitetin pasi nuk ka asnjë element sigurie dhe që qone se ndodhet mes një zone te banuar	16.10.2025	Bazuar në kërkesë -ankesën tuaj ardhur me email në adresën info@ishti.gov.al, protokolluar me nr 9549 datë 01.10.2025, si dhe autorizimin lëshuar nga ISHTI-i Nr.9567 Prot dt.01/10/2025 për inspektimin e subjektit nga grupi i inspektorëve u bë verifikimi. Nga inspektimi rezultoi se subjekti dispononte një rezervuar gln me volum 5000 litër me nr. fab. 408636 dhe vit prodhimi 2003. Nga kontrolli i shtantave siç rezultoi se nivel treguesi shteson një sasi gazi gjëje rreth 50 % u dhe manometri shteson një presion 7 bar. Gjithashtu në vendodhje tëk bazamenti i betonit ishte vendosur një pompë gazi dy fazore, u gjet dhe një peshore. Në vendodhje nuk u gjet asnjë bombol gln-je e lëvizshme. Subjekti nuk dispononte asnjë lloj dokumentacioni tekniko ligjor. Menjëherë për të ndërprerë aktivitetin e tregimit të gln-së rezervuari u plumbos me vala me logo ISHTI me Nr: 315140; 315134; 315131. Pas gjithë këtyre veprimeve u plotësua Listë Verifikimi: ProcesVerbal dhe Vendimi i Ndërmjetës ku iu la për detyrë brenda një afati 10 ditor heqja e rezervuarit, ose në pamedull të heqjes për shkak të kushteve të vështira të bëhet konservimi i tij (mbledhja me ujë). Më datë 13.10.2025 u krye përsëri kontrolli në vendodhjen e subjektit për verifikimin të detyrave të lëna nga ku rezultim se subjekti i ka shkëputur linjat teknologjike si dhe e ka mbushur rezervuarin e gln-së me ujë. Subjekti u ndëshkua me masë administrative.	E plotë	0
3	06.10.2025	Kërkohet konfirmimi për kryerjen e keyreve analizave të parametrave te meposhtiem në moster argjile : Kadline Illini Montmorilloniti Karboonati	09.10.2025	Ju bejme me dije se Drejtoria e Laboratorit Qendror prane ISHTI, nuk kryen analizat e kerkuara nga ju sepse nuk jane pjesë e fushes sone te veprimtarise.	E plotë	0
4	10.10.2025	Kërkohet informacion lidhur me kapacitetet depozituese të subjekteve për pajisje me licencë tregtimi?	14.10.2025	Në përgjigje të email-it Tuaj, dërguar me datë 10.10.2025, Protokolluar në ISHTI me Nr. 9923 Prot datë 10.10.2025, në të cilin kërkohet informacion lidhur me kapacitetet depozituese të subjekteve për pajisjen me Licencë tregtimi, ju informojmë si më poshtë: Inspektorati Shtetëror Teknik dhe Industrial (ISHTI) është organ i specializuar për kontrollin e veprimtarisë të personave juridikë në fushën hidrokarbure, udhërrim kontrolli në të gjitha subjektet në përpajshje me dispozitat e ligjit nr. 99/2024 “Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë”, ligjit nr. 8450 datë 24.02.1999 “Për përpunimin, transportimin dhe tregtimin e naftës, të gazit dhe nënprodukteve të tyre”, të ndryshuar; Ligjit nr 32/2016, datë 24.03.2016 “Për garantimin e sigurisë së punës së pajisjeve dhe instalimeve nën presion”, si dhe aktet nënligjore që rrjedhin prej tyre. Në zbatim të ligjit Nr. 99/2024 “Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë”, si dhe Programeve vjetore dhe majore të miratuara, shoqëritë e pajisura me Licencë të tregimit me shumicë që kryejnë veprimtari në fushën hidrokarbure janë inspektuar dhe do të inspektohen në vazhdim nga ISHTI për kontrollin e zbatimit të ligjshmërisë. Një nga kërkesat e inspektimeve është edhe kontrolli i respektimit të kapaciteteve depozituese dhe magazinuese të shoqërive që kryejnë veprimtari të tregimit me shumicë të naftës dhe nënprodukteve të tyre, si për kapacitetet në pronësi ose me qira sipas përcaktimeve të pikës b, Paragrafi I-të “Procedurat e dhënies së licencave të tregimit me shumicë të naftës bruto dhe nënprodukteve të saj” të VKM nr.970, datë 02.12.2015. Për përcaktimin e procedurave dhe të kushteve për dhënien e licencave për tregtimin e naftës bruto dhe nënprodukteve të saj, të ndryshuar.	E plotë	0
5	15.10.2025	Ju lutemi kërkojmë një përgjigje zyrtare nga ana juaj lidhur me dispozitat e ligjit Nr. 8450 Për naften...i ndryshuar. Duke u bazuar në analizën e nëneshë të bazës ligjore te meposhtme kërkojmë një përgjigje zyrtare nga ju me shkrtim lidhur me mundësinë ligjore që kanë shoqëritë stacion shitje karburanti dhe/ose njësi shitje lende djegëse që te kryejnë furnizime me autobot mjet tokësor, pasi rezultati që stacionet e shitjes ligjerisht duhet te shesin vetem me pistolette publike dhe njësite e lendeve djegëse nuk kanë parashikim ligjor për pajisjen e autoboteve apo mjeteve te tjera as ne ligj sic ndodh për shoqëritë e shumicës e as ne VKM Nr. 970. Neni 14 për shoqëritë e shumicës pika 4. Shoqëritë e tregimit me shumicë transportimin e naftës, gazit dhe nënprodukteve të tyre e bëjnë me naftësjellës, në baze te kontratës se transportit, te lidhur me 10, me mjete transporti bekuradshor, detar dhe tokësor, te cilat janë te pajisura me licencë, ne përpajshje me ligjin nr.8308, date 18.8.1998 “Për transportet rrugore”. Këto mjete transporti mund te jene prone e shoqërisë se tregimit me shumicë ose mund te merren ne përdorim për tyre kundrejt pagesës. Shoqëria e tregimit me shumicë përgjigjet për sasi të cilësisë e ngarkesës gjate transportit. Neni 15 për stacionet e shitjes pika 1 Me përjashtim te nënproduktit te kategorisë IV/A, nënproduktet e tjera tregohen vetëm nëpërmjet aparateve te matjes dhe te regjistrimit te sasise se shitjes dhe pika 4. Stacioneve te shitjes se karburanteve u ndalohej te tregojnë karburante për mjete transporti, detar e ajror, si dhe lende djegëse te lëngta apo te gazta si dhe Neni 16 për Njësite e lendeve djegëse si dhe VKM Nr. 970, datë 2.12.2015 PËR PËRCAKTIMIN E PROCEDURAVE DHE TË KUSHTEVE PËR DHËNIEN E LICENCAVE PËR TREGTIMIN E NAFTËS BRUTO DHE NËNPRODUKTEVE TË SAJ e ndryshuar, kreu I pika 3 germa e) Vërtetimin e pronësisë ose kontratës e marrjes në përdorim për autometjet e transportit për naftë bruto dhe nënproduktet e saj, që do të përdorë personi juridik, sipas përcaktimeve të pikës 2 të kreut III dhe Kreut III pika 7. Shoqëritë aksionare, që kërkojnë të pajisen me licencë tregtim me shumicë, duhet të kenë në pronësi ose në përdorim, në çastin e kërkesës për licencë dhe gjatë gjithë kohës së veprimtarisë, të pajtis, një autometjet të transportit për naftë bruto dhe nënprodukteve të saj, për secilin produkt që do të tregohet si dhe duke pare kreun II ku nuk thuhet asgjë për pajisjen e asje autometri nga stacionet e shitjes se karburanteve dhe njësite te lendeve djegëse për konsumatorët fondorë, PYESIM ISHTIN-a a lejohet ligjerisht që shoqëritë ne formen ligjore te stacionit te shitjes se karburantit si dhe njësi shitje lende djegëse te kryejnë furnizime me autobot pra me mjete tokësore transporti apo transporti nga keto shoqeri është i denueshem dhe nuk lejohet?	17.10.2025	Në përgjigje Tuajës protokolluar me Nr. 10114 Prot., datë 15.10.2025, dërguar përmes adresës elektronike zyrtare të ISHTI-t lidhur me kuadrin ligjor të furnizimit me karburante nga ana e stacioneve të shitjes me pakicë të karburanteve si dhe njësite të lendeve djegëse për përdorim nga konsumatorët fondorë, ju bëjmë me dije se: Inspektorati Shtetëror Teknik dhe Industrial (ISHTI) është struktura përgjegjëse për kontrollin e respektimit të standardeve për cilësi të naftës dhe nënprodukteve të saj, për personat juridikë që zhvillojnë aktivitetin e tyre në fushën e përpunimit, transportimit dhe tregimit të naftës, gazit dhe nënprodukteve të tyre, në përpajshje me dispozitat e ligjit Nr. 8450 datë 24.02.1999 “Për përpunimin, transportimin dhe tregtimin e naftës, të gazit dhe nënprodukteve të tyre”, të ndryshuar, si dhe akteve ligjore e nënligjore në fuqi. Në zbatim të kuartit ligjor në fuqi, tregtimi me pakicë i karburanteve lejohet të kryhet vetëm në stacionet e karburanteve të miratuara për këtë qëllim dhe të licencuara nga organet kompetente. Stacionet e shitjes së karburanteve sipas nenit 15 pika 1) të ligjit nr. 8450/1999 të ndryshuar, me përjashtim të nënproduktit të kategorisë IV/A, nënproduktet e tjera tregohen vetëm nëpërmjet aparateve të matjes dhe të regjistrimit të sasise së shitjes. Çdo formë tjetër furnizimi i autometjeve ose depozitave janë të kushteve teknike të përcaktuara në ligj, ndalohet. Vendimi Nr. 970 datë 2.2.2015, kreu II, rregullon procedurat për dhënien e licencave për tregtimin me pakicë për stacionet e shitjes së karburanteve dhe të njësite të lendeve djegëse për konsumatorët fondorë. Përdorimi i autometjeve për furnizim lejohet vetëm për subjektet që zotërojnë licencë tregimi me shumicë dhe që kanë autorizim të posaçëm, por jo për furnizimin e autometjeve apo të konsumatorëve fondorë. Sa më sipër, dispozitat ligjore parashikojnë se vetëm shoqëritë, të cilat zotërojnë licencë tregtimi me shumicë, gjatë gjithë kohës së ushtrimit të veprimtarisë së tyre duhet të kenë në pronësi ose në përdorim një autometjet në lidhje me transportin për naftën bruto dhe nënproduktet e saj. Çdo veprim në kundërshtim me këto dispozita përben shkelje administrative.	E plotë	0

6	21.10.2025	Në vijim të kërkesës tonë për sqarim, duhet të evidentojmë edhe Nenin 14 pika 13. Shoqëria e tregimit me shumicë përgjigjet për sasinë dhe cilësinë e ngarkesës gjatë transportit. Pra ligji ngarkon me përgjegjësi vetëm shoqëritë e shumicës për cilësinë dhe sasinë gjatë transportit, pra përderisa ligji ngarkon këto vetëm ka një cilësi më të lartë sigurie për keto lloj shoqërish dhe kërkesë më të të lartë përgjegjësie. Vetë ligji tek neni 1/1 Përkufizime thotë dhe konceptin e transportit e transportuesit: 7. "Transportin" është procesi i lëvizjes së naftës bruto apo nënprodukteve të saj nga një vend në një tjetër nëpërmjet tubacioneve dhe mjeteve të posaçme të transportit që përshkojnë një distancë të caktuar. 8. "Transportues" është personi, fizik apo juridik, që transporton naftën dhe nënproduktet e saj me anë të mjeteve specifike të autorizuara. Per shoqëritë stacion shitje dhe njësi lënde djegëse nuk janë keto parashikime ligjore dhe as nuk përmendet fare transporti si täger që keto shoqëri mund të kenë.	29.10.2025	Në vijim Tuasjes me Nr. 10114/2 Prot., datë 21.10.2025, dërguar përmes adresës elektronike zyrtare të ISHTI-t lidhur me informacionin për furnizimin me karburant për ngrohje për kalidaja, përfshirë shkoila e institucione të ndryshme, bëjmë me dije se. Inspektorati Shtetëror Teknik dhe Industrial (ISHTI) është struktura përgjegjëse për kontrollin e respektimit të standarteve për cilësinë e naftës dhe nënprodukteve të saj, për personat juridik që zhvillojnë aktivitetin e tyre në fushën e përpunimit, transportimit dhe tregimit të naftës, gazit dhe nënprodukteve të tyre, në përputhje me dispozitat e ligjit Nr. 8450 datë 24.02.1999 "Për përpunimin, transportimin dhe tregimin e naftës, të gazit dhe nënprodukteve të tyre", të ndryshuar, si dhe akteve ligjore e nënligjore në fuqi. Në zbatim të kuaadrit ligjor në fuqi, stacionet e shitjes së karburanteve konsiderohen instalime të posaçme me mjetet matëse me të cilat realizohet shitja e karburanteve të llogjta për autonjete. Tregimi me pakicë i karburanteve kryhet vetëm në pika të miratuara për këtë qëllim dhe të licencuara nga organet kompetente. Stacionet e shitjes së karburanteve sipas nenet 15 pika 1) të ligjit nr. 8450/1999 të ndryshuar, me përjashtim të nënproduktit të kategorisë IV/A, nënproduktet e tjera tregohen nëpërmjet aparateve të matjes dhe të regjistrimit të sasisë së shitjes. Çdo formë tjetër tregimi është në kundërshtim me legjislacionin në fuqi. Në nenin 14 të ligjit nr. 8450/1999 të ndryshuar, "Shoqëritë e tregimit me shumicë". Veprimtaria e tregimit me shumicë të naftës bruto, gazit natyror dhe nënprodukteve të tyre, të vendit a të importit, ushtrohet nga shoqëritë e tregimit me shumicë. Shoqëritë e tregimit me shumicë kanë të drejtë të furnizojnë, sipas kushteve të licencës përkatëse, rafineritë e naftës, impiantet e përpunimit, shoqëritë e tregimit me pakicë, të pajisura me licencë tregimi, mjetet detare dhe ajrore, si dhe konsumatorët e mëdhenj. Sa më sipër, dispozitat ligjore parashikojnë se tregimi me shumicë i naftës, gazit dhe nënprodukteve të tjera ushtrohet vetëm nga shoqëritë tregtare, të themeluara në formën e shoqërive aksionare, pasi të jenë pajisur me leje tregimi, sipas dispozitave të këtij ligji.	E plotë	0
		w				